

STATUTI
I SHOQERISE AKSIONARE
RECOVERED EARTH PATOS sh.a.

Perkufizime

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është statuti i shoqërisë;



Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 14.07.2017, ne, themeluesit, kemi krijuar shoqërine aksionare pa oferte publike me emrin "Recovered Earth Patos ShA.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- Recovered Earth Patos sh.p.k., me NUIS L61503033C me seli ne Lalar-Patos-FIER, Nr pasurie 2033, Zona Kadastrale 2374, Volum 9, Faqe 29

- z. Michael James Mills, shtetas amerikan, lindur me 13.06.1967 ne Ohio, Shtetet e Bashkuara te Amerikes, mbajtes i pasaportes Nr. 515495786 te Shteteve te Bashkuara te Amerikes, me adrese ne: Tirane, sheshi "Italia", Hotel "Sheraton", kati 2, zyra 9.

- z. Theodor Laçi, shtetas britanik, lindur me 27.08.1973 ne Mitrovice, mbajtes i pasaportes Nr. 801707773 te Mbreterise se Bashkuar te Britanise se Madhe dhe Irlandes se Veriut, me adrese ne: Tirane, sheshi "Italia", Hotel "Sheraton", kati 2, zyra 9

- z. Irfan Isufaj, shtetas shqiptar, lindur me Fier ne 25.01.1958, leternjoftimit nr. 024644010 e numer personal F80125181E te Republikes se Shqiperise, me adrese ne: Fier, Rr. Fred Gjini, L.15 Tetori, hyrja 1.

- z. Bledar Rakipaj, shtetas shqiptar, lindur me 30.04.1991 ne Shkoder, mbajtes i pasaportes nr. BE5250265 te Republikes se Shqiperise, me adrese ne: Tirane, Rr.Dervish Hima, pall "Al-Gi", kati 4.

Neni 2

Objekti

Krijimin, instalimin dhe venien ne shfrytezim te gjitha paisjeve, impiante, stacioneve, reparteve dhe linjave per ushtrimin e perpunimit e tregtimit te produkteve hidrokarbure si vetem ashtu dhe ne bashkepunim me shoqeri te tjera tregtare, persona juridik vendas apo te huaj. Kryerjen e transportit si brenda vendit dhe ate nderkombetar te tyre me mjetet e veta te transportit tokesor e atij detar ose atyre te te treteve. Import eksportin dhe tregtimin me shumice e pakice te teknologjise dhe pjeseve te kembimit te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise hidrokarbure. Veprime në fushën e ambientit, Ndertimin dhe venien ne perdorim per vete dhe per te trete te depove te hidrokarburave. Import eksport dhe tregti me shumice e pakice te produkteve

industriale, bujqesore e blegtorale. Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe prodhim inertesh. Agjensi turistike, doganore dhe spedicionere. Sherbime financiare.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë **PA AFAT** te caktuar.

Neni 4

Selia

(1) Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Lalar-Patos-FIER, Nr pasurie 2033, Zona Kadastrale 2374, Volum 9, Faqe 29

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë do te jete 3,500,000 Lekë, i ndarë në 3500 (tremije e peseqind) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 (njemije) Leke secili. Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
- Aksionari themelues "**Recovered Earth Patos sh.p.k.**": kontribut ne para, numri i aksioneve 350 dhe vlera e aksioneve: 350.000 Leke; perqindja ne kapital 10%;
 - Aksionari themelues "**Michael James Mills**": kontribut ne para: numri i aksioneve 1935.5 dhe vlera e aksioneve: 193,550 Leke; perqindja ne kapital 55.3 %;
 - Aksionari themelues "**Theodor Laçi**": kontribut ne para: numri i aksioneve 850.5 dhe vlera e aksioneve: 85,750 Leke; perqindja ne kapital 24.3%;
 - Aksionari themelues "**Irfan Isufaj**": kontribut ne para: numri i aksioneve 189 dhe vlera e aksioneve: 18,900 Leke; perqindja ne kapital 5.4%;
 - Aksionari themelues "**Bledar Rakipaj**": kontribut ne para: numri i aksioneve 175 dhe vlera e aksioneve: 17,500 Leke; perqindja ne kapital 5%.

Neni 6

Kërkesa për të paguar aksionet

- (1) Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- (2) Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë

MSM

solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 7

Llojet dhe kategoritë e aksioneve

- (1) Aksionet janë të zakonshme. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Per te shmangur çdo paqartesi lidhur me sa me sipër, përveçse kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe në unanimitet votash të gjithë aksionareve në Shoqëri, përqindja e aksioneve në kapital e aksionareve nuk do të ndryshojë në asnjë rast tjetër dhe vlera e aksioneve do të korespondojë në çdo rast me përqindjen në vlerë mbi totalin e kapitalit të shoqërisë, pavarësisht rritjeve apo ndryshimeve në kapital dhe pavarësisht kontributeve të aksionarit apo aksionareve.

Neni 8

Regjistri i aksioneve

- (1) Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
- (2) Administratori është përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të aksioneve të shoqërisë e detyrohet të lejojë aksesin në informacionet e regjistrimit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon.

Neni 9

Menyrat e fitimit dhe kalimit të Aksioneve

- (1) Aksionet e shoqërisë aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
- (2) Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit.

Neni 10

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues, me vendim unanimitet të gjithë aksionareve në asamblenë të përgjithshme. Kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zmadhohet duke emetuar aksione të reja për t'u nënshkruar nga aksionare të rinj.
- (2) Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimitet të të

M5N

gjithë aksionarëve.

- (3) Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme, me vendim unanimit të gjithë aksionareve në Shoqëri, mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar me aktivet e shoqërisë, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

Neni 11

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim unanimit të asamblesë së përgjithshme.
- (2) Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulimit aksionesh.

Kreu III

Organet e shoqërisë

Neni 12

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionare janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit;
- c) Administratori.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme

- (1) Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
- d) përcaktimin e politikave tregtare;
 - e) ndryshime të statutit;
 - f) emërimin e anëtarëve të këshillit të administrimit
 - g) shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit
 - h) emërimin dhe revokimin e administratorit
 - i) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - j) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
 - k) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - l) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - m) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - n) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - o) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - p) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - q) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - r) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - s) emetimin e aksioneve të reja
 - t) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

- (2) Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Ekspert Kontabel i autorizuar emerohet z. Teit Gjini, shtetas shqiptar, lindur me 08.01.1970 ne Elbasan, mbajtes i pasaportes nr. BF8915331 te Republikes se Shqiperise, me adrese ne: Tirane, Rr.Emin Duraku, pallatet "Binjaket", Nr.5, kati 2.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme thirret ne rastet e parashikuara nga Neni 136 i Ligjit nga Administratori, nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit.
- (2) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Neni 15

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Anëtarët e Asamblese se Përgjithshme mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, përfshirë komunikimin video dhe audio konference, ne prani te noterit public akte tete cilit kane vlere fuqiplote dhe vlere per tu regjistruar e ekzekutuar.
- (2) Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.
- (3) Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.
Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.
- (4) Administratori ose anëtari i Këshillit të Administrimit pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 16

Marrja e vendimeve

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitetin e votave te gjithe aksionareve ne Shoqeri per çeshtjet e parashikuara ne nenin 13 (1) germa b), c), e), f) g), h), i), j) k), l), n) dhe p).
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të aksionareve pjesëmarrës ne

mbledhje, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 13 të këtij statuti. Vendimi Qarkullues me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Asamblese së Përgjithshme do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Asamblese së përgjithshme, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

Neni 17

Këshilli Administrimit

- (1) Asambleja e Përgjithshme cakton tri persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me unanimitet të gjithë aksionareve në Shoqeri, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Aksionari që zoteron 5% të kapitalit të regjistruar ka të drejtën të emerojë një anëtar të Këshillit të Administrimit me një vendim të posaçëm si dhe ta shkarkojë atë në çdo kohë. Vendimi i posaçëm konsiderohet i njoftuar me marrjen e tij në seline të Shoqërisë. Anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra me shumicë të thjeshtë votash në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- (2) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.
 - Mirjeta Toçila, shtetas shqiptar, lindur me 20.02.1962 në Korçë, mbajtes e letërnjoftimit nr.025183717 / nr.personal G25220274L të Republikës së Shqipërisë, me adresë në: Tiranë, Rr. Dhimiter Kamarda, pall.10, shkalla 1, ap.19.
 - Shkelqim Rakipaj, shtetas shqiptar, lindur me 16.12.1952 në Shkoder, mbajtes i pasaportes nr. BE8933358 të Republikës së Shqipërisë, me adresë në: Tiranë, Rr.Dervish Hima, pall "Al-Gi", kati 4.
 - Gentian Bala, shtetas shqiptar, lindur me 10.05.1974 në Shkoder, mbajtes i pasaportes nr. BG7935892 të Republikës së Shqipërisë, me adresë në: Tiranë, Rr. Andon Z. Cajupi, pall 20/1, Ap26.

Neni 18

Kompetencat e Këshillit të Administrimit

- (1) Këshilli i Administrimit:
 - a) udhëzon dhe jep direktiva për Administratoren në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe kontrollon përputhshmërinë e veprimeve të tyre me Ligjin dhe Statutin
 - b) kontrollon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - c) thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - d) kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - e) shqyrton dhe kontrollon librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - f) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshtkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - g) siguron që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit

F. A. [Signature]

MSM


nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "f" me lart, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

- h) përcakton kompetencat dhe shperblimin e administratorit;
 - i) miraton marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
 - j) miraton kryerjen e pagesave mbi shumën 50,000 (pesëdhjetmije) Usd apo ekuivalentin në një monedhë tjetër.
 - k) vendosë lidhjen nga Shoqëria të çdo kontrate apo marrëveshje me natyrë afatgjatë dhe/ose marrjen përsipër të detyrimeve mbi shumën e përcaktuar në germen j) me sipër, si dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
 - l) siguron informacionin sipas kërkesës së aksionarit me marrjen e njoftimit prej tij
- (2) Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të delegojnë kompetencat e tyre dhe detyrat që u janë ngarkuar me ligj.

Neni 19

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- (1) Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën tri herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit. Mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit të Administrimit do të mbahen edhe kur thirret nga një prej anëtarëve të tij apo Administratori si pasoje e nevojave të administrimit të shoqërisë.
- (2) Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtarë në momentin e emërimit.
- (3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administratori nuk mund të emërohet si Kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (4) Çdo mbledhje e Këshillit Drejtues do të thirret nga Kryetari apo kërkesës së njerit prej anëtarëve apo administratit, jo më heret se 3 ditë pune nga koha e planifikuar përmes një njoftimi me shkrim ndaj secilit prej anëtarëve, shoqëruar me çështjet e rendit të ditës si dhe dokumentacionin që do të parashtrahet për diskutim gjatë mbledhjes.
- (5) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëllë si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose në komitetin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.



Neni 20

Marrja e vendimeve të Këshillit të Administrimit

- (1) Këshilli i Administrimit vendos unanimitisht për çështjet parashikuara në nenin 19 (1) (germa h), i), j) e k).
- (2) Këshilli i Administrimit vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 19 të këtij statuti.
- (3) Vendimi Qarkullues me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.
- (4) Nëse Këshilli i Administrimit, në tri mbledhje të tij të njëpasnjeshme nuk arrin vendimmarrjen me unanimitet për çështja I kalon për vendimmarrje Asamblese së Përgjithshme.

Neni 21

Perfundimi i detyres së anëtarëve të Këshillit të Administrimit

- (1) Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:
 - a) personi nuk është më anëtar i Këshillit të Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit.
 - b) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
 - c) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
 - d) ka munguar për më shumë se tri mbledhje radhazi në mbledhjet e këtij këshilli pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit dhe Këshilli i Administrimit vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 22 Administratori

- (1) Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa çënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.
- (2) Administratorët i parë të Shoqërisë emrohet Michael James Mills, shtetas amerikan, lindur më 13.06.1967 në Ohio, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbajtes i pasaportes Nr. 515495786 të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me adresë në: Tiranë, sheshi "Italia", Hotel "Sheraton", kati 2, zyra 9.
- (3) Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e dhena nga Këshilli I Administrimit apo në mungesë të tyre, në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenin 159 të Ligjit.

Neni 23

Perfundimi i detyres së Administratorit

- (1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
 - a) personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
 - c) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose



Kreu IV

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 24 Dividendët

- (1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria unanimitet të votave të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- (2) Të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me sa percaktuar ne nenin 7 (1) te ketij Statuti brenda tri muajsh nga mbyllja e vitit financiar te Shoqerise.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 25

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

- (1) Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me unanimitet votash te te gjithë aksionareve ne Shoqeri, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Kreu V

Prishja dhe njoftimet

Neni 26

Prishja dhe likuidimi

- (1) Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me unanimitet votash te te gjithë aksionareve ne Shoqeri, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve.

Neni 27

Baza Ligjore

- (1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar. Nëse nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Mosmarreveshjet

- (1) Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.



Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

Aksionari Michael James Mills, shtetas amerikan, mori dijëni për përmbajtjen e këtij Statuti nga përktimi i bërë në gjuhën angleze prej _____

Aksionarëve Themelues të shoqërisë

Emri i shoqërisë

RECOVERED EARTH PHOTO SHA

Emrat dhe nënshkrimet e aksionarëve

Michael J. Mills

Theodor C. C. C.

John J. J. J.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
NOTER GAZMIR BEGAJ, FIER
Cel. (+355)0692136501
e.mail: gazmir.begaj@yahoo.com
Nr. 2812 rep.

U PAGUA TAKSA
E PULLES
NOTER G. BEGAJ



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Fier , sot me date 17 Korrik 2017 para meje Noter Gazmir Begaj anetar i Dhomes se Notereve Vlore, me zyre noterie prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier u paraqiten personalisht shtetasit :

Michael James Mills , lindur me 13.06.1967 ne OHIO, SHBA , madhor me zotesi te plote per te vepruar identifikuar prej meje Noterit me pasaporten me nr.515495786.

Theodor Laci , lindur me 27.08.1973 ne Mitrovice , madhor me zotesi te plote per te vepruar identifikuar prej meje Noterit me pasaporten me nr.801707773.

Irfan Isufaj lindur me 25.01.1958 ne Kurjan, Fier , madhor me zotesi te plote per te vepruar identifikuar prej meje Noterit me leternjoftimin me nr.personal: F80125181E

Bledar Rakipaj lindur me 30.04.1991 ne Shkoder , madhor me zotesi te plote per te vepruar identifikuar prej meje Noterit me pasaporten me nr.personal: J10430068C .

Shtetasit e mesiperm me vullnetin e tyre te lire e te plote nenshkruan ne pranine time STATUTIN e Shoqerise Aksionare :

“ RECOVERED EARTH PATOS ” Sh.A .

Une Noteri ne baze te nenit 55 te ligjit 7829 date 01.06.1994 “ Per Noterine “ vertetoj sa me siper .

NOTER
GAZMIR BEGAJ

